

Karta e-parë e përgjithëshme e apostollit Pjetër

Krye 1.

- 1 Pjetri, apostoll i Jisu Krishtit, mb' ata që rrinë ndë dhe të-huaj, të-përndarë ndëpër Pont e ndëpër Gallati, e ndëpër Kappadhoqi,
- 2 e ndëpër Asi, e ndëpër Vithini, Të-sgjedhurë pas të-parënjohurit të Perëndisë, Atit, me anë të shënjtërimit të Frymësë, për dëgjim e për përskatje të gjakut të Jisu Krishit; hir edhe paqtim ushumoftë mbë ju.
- 3 Qoft' i-bekuarë Perëndia edhe Ati i Zotit t'ënë Jisu Krisht, i-cili pas përdëllimit të ti të-shumëtë na polli përsëri ndë një shpresë të-gjallë më anë të të-ngjallurit të Jisu Krishit
- 4 prej së-vdekurish, Për një trashëgim të paprishur' e të-papëgërë e të-pafyshkurë, që
- 5 është ruajturë ndë qiejt për ne, Të-cilëtë

- me fuqin' e Perëndisë ruhemi me anë të besësë, për shpëtim të-gatishim të sbulonetë
- 6 ndë kohët të fundit. Për këtë gëzohi, ndonëse tashti pakëzë, (ndë udashtë), hidhëro-
- 7 hi mbë çdo farë të-ngarash, Që provimi i besës' s'uaj që është shumë m' i-çëmuarshim se ari që prishetë, ndonëse provonetë me anë zjarri, të gjëndetë për lëvdim e për nder e për lavdi, kur të sbulonetë Jisu Kri-
- 8 shti; Të-cilinë, ndonëse s'e keni parë, e doni; mbë të-cilinë, ndonëse tashti nuk' e shihni, besoni edhe gëzohi me gëzim të-lavduruar-
- 9 shim që s'munt të rrëfenetë me gojë, Dyke marrë të-pastajmen' e besësë s' uaj, shpëti-
- 10 min' e shpirtëravet; Për të-cilinë shpëtim kërkuan' edhe vëshguanë profitëritë që profitepsnë për hirinë që dotë epej mbë ju;
- 11 Dyke vëshguarë mbë cilënë a mbë ç' farë kohe çfaqte Fryma e Krishtit që ishte mb' ata, kur dëshmonte më përpara për të-pësuarat' e Krishtit, edhe për lavditë pas atyre-
- 12 reve; Mbë të-cilët usbulua jo për vetëhen' e tyre, po për ne i punonin' ato punëra, të-cilatë tashti urrfëyenë mbë ju me anë t' atyreve që ungjillëzuan' ungjillinë mbë ju me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë, që udërgua nga qielli, mbë të-cilatë ëngjëjtë dëshëronjënë të kërrusen' e t' i shohënë.
- 13 Përandaj si të ngjishni mezat' e mëndjesë s'uaj, përmbani vetëhenë nga të-ligatë, edhe

- kini shpresë të-plotë mbë hirinë që dotë
vinjë mbë ju, kur të sbulonetë Jisu Krishti,
- 14 Si djem të-dëgjuarshim, pa bërë vetëhenë
t'uaj mbë një formë me dëshërimet' e-parë,
- 15 që kishitë ndë paditjet t'uaj; Po sikundrë
është shënjt ay që u thirri juve, kështuedhe
ju bëhi shënjtorë mbë gjithë të-sjellatë t'uaj;
- 16 Sepse është shkruarë, „Bëhi shënjtorë, sepse
unë jam shënjt.“
- 17 Edhe ndë quani Atë atë që gjykon pa
mbajtur' anë pas punës'së gjithësicilit,shko-
ni me frikë kohën' e të-ndënjurit t'uaj ndë
- 18 këtë dhe të-huaj që rri; Dyke diturë se
nuk' uçpërblyetë nga jeta juaj e-kotë që u
kanë lënë juve atëritë me gjërëra që prishenë,
- 19 si me ergjënt a me ar, Po me gjakun' e-
paçëmuarë të Krishtit, posi një qëngji pa
20 palavi e pa të-shgjërryerë; I-cili qe urdhë-
ruarë përpara se të ngrihetë bota, e uçfaq
21 ndë kohërat të fundit për ju, Që me anë
t'ati i besoni Perëndisë që e ngjalli atë
prej së-vdekurish, edhe i dha ati lavdi, që
besa juaj edhe shpresa të jetë mbë Perën-
dinë.
- 22 Si të qëroni pra shpirtëratë t'uaj me të-
binduritë t'uaj ndë të-vërtetët me anë të
Frymësë, për një dashuri vëllazërie e pa dy
faqe, të doni fort njëri tjetërinë prej zëmëre
23 së-kthjellëtë; Sepse jeni lindurë përsëri jo
prej fare që prishetë, po prej fare që s'

- prishetë, me anë të fjalës' së Perëndisë që
24 rron e që mbetetë (për gjithë jetënë). Sepse
„çdo mish është posi bar, edhe çdo lavdi
njeriu posi lule bari; utha bari, edhe lulja e
25 ati ra; Po fjal' e Zotit mbetetë për gjithë
jetënë.“ Edhe këjo është fjala që uungjillëzua
mbë ju.

Krye 2.

- 1 Si të hithni tej pra çdo ligësi e çdo ko-
bim, e ipokrisira, e cmire, e çdo të-përfolura,
2 Posi foshnja lindurë rishtazi, të dëshëroni
qymështin' e thjeshtë të shpirtit, që të rri-
3 teni me anë t'ati; Sepse e keni ngjëruarë
„se Zoti është' i-mirë.“
- 4 Mbë të-cilinë dyke ardhurë posi mbë gur
të-gjallë, të-hedhurë tej nga njerëzitë, po të-
5 sgjedhurë nga Perëndia e të-nderçim, Edhe
ju, posi gurë të-gjallë, ndërtohi mbë shtëpi
shpirtërie, priftëri të-shënjtëruarë, që të bini
kurbanë shpirtërie, të-pëlqyerhim te Perëndia
6 me anë të Jisu Krishtit. Përandaj edhe është
shkruarë ndë shkronjë, „Na tek vë ndë
Sion një gur krye çipi, të-sgjedhurë, të-nder-
çim; edhe ay që i beson ati nukë dotë tur-
7 përonetë.“ Mbë ju pra që besoni është nderi
vetë; po mbë të-pabinduritë, „guri që hoth-
në tej ata që ndërtoninë“, ky ubë krye çipi
edhe „gur pengese, edhe gur skandhalie;“
8 Të-cilëtë pengonenë ndë fjalët, sepse nukë

- bindenë ; për të-cilënë *gjë* edhe ishinë ndarë.
- 9 Po ju jeni „gjindje e-sgjedhurë, priftëri mbretërie, komp i-shënjtëruarë,“ llaus që fitoj *Perëndia*, që të rrëfeni mirësit' e ati, që u thirri juve nga errësira ndë dritët të ti të-
- 10 çudiçime ; *Ju*, të-cilëtë njëherë nuk' *ishitë* llaus, po tashti *jeni* llaus i Perëndisë ; *ju* që njëherë nuk' ishitë të-përdëllyerë, po tashti upërdëllyetë.
- 11 O të-dashurë, u lutem *juve* si të-huaj e të-ardhurë *që jeni*, të hiqni dorë nga dëshërimet' e mishit, të-cilëtë janë ndë luftë kundrë shpirtit ; Të keni të-sjellatë t'uaj të-mira ndër mest të kombevet, që, tek u përflasënë juvë për keqbërës, kur të shohënë punëratë t'uaj të-mira, të lavduronjënë prej atyre Perëndinë ndë ditët të të-ardhurit.
- 13 Unjni pra kryetë çdo urdhëri prej njeriu,
- 14 për Zotinë ; Kaqë mbretit, se qëndron mbë lart nga gjithë, sa *edhe* qivernitarëvet, si të-dërguarë prej ati për të marrë çpagim nga ata që bënë keq, e për të lëvduarë ata që bënë një mirë. Sepse kështu është dashurimi i Perëndisë, që dyke bërë mirë t' i mbyllni gojëne padituris' së njerësvet të-marrë ;
- 16 Si të-lirë, e jo si *njerës* që kanë lirinë *për* mbyllesë të ligësisë, po si shërbëtorë të Perëndisë. Nderoni të-gjithë ; doni vëllazërinë ; kini frikë Perëndisë ; nderoni mbretinë.
- 18 *Ju* shërbëtorëtë, unjni kryetë zotërinjvet *t'uaj*

- me çdo frikë, jo vetëmë të-mirëvet e të-
- 19 butëvet, po edhe të-shtrëmbërvet ; Sepse këjo është hir, të duronjë njeriu hidhërimë për ndërgjegjenë mbë Perëndinë, dyke pësuarë pa udhë.
- 20 Sepse ç' farë lavdie *është*, ndë durofshi, kur të rriheni për fajë ? po ndë durofshi dyke bërë mirë e dyke hequrë keq, këjo
- 21 *është* hir për anë Perëndisë. Sepse për këtë uthërritë, sepse edhe Krishti pësoj për ju, e u la juve një shëmbëllesë, që të ecëni pas
- 22 gjurmëvet t'ati ; I-cili „nukë bëri faj, as
- 23 ugjënt kobim ndë gojë t'ati.“ I-cili kur për-qeshej nukë për-qeshte, kur pësonte nukë frikësonte, po epte vetëhen' e ti ndë dorët
- 24 t'ati që gjykon me të-drejtë ; I-cili vetë mbajti fajetë t'anë ndë trupt të ti mbi drut, që, si të vdesëmë ndë fajet, të rrojmë ndë drejtë
- 25 tëri ; „me plagën' e ati ushëruatë.“ Sepse ishitë „si dhën të-aratisura ;“ po tashti ukthyetë te Bariu edhe tek Episkopi i shpirtërvet t'uaj.

Krye 3.

- 1 Gjithashtu edhe *ju* gratë, unjni kryetë burravet t'uaj, që, edhe ndë mos ubinçinë ca *veta* ndë fjalët, të fitonenë pa fjalë nga
- 2 të-sjellat' e gravet, Si të shohënë të-sjellatë
- 3 t'uaj të-thjeshta e me frikë. Të-cilavet stolia letë mos jetë e-përjashtëshme, ajo e te-gërshetua-

- rit të flokëvet e të të-varurit të stolivet të-arta, 4 a të të-veshurit të rrobavet, Po njeriu i-fshehurë i zëmërsë, *stolisurë* me paprishjen' e frymës' së-butë edhe së-qetë, e-cila përpara
- 5 Perëndisë është shum' e-vëjyerë. Sepse kështu njëherë edhe grat' e-shënjtëruara, ato që shpreninë mbë Perëndinë, stolisninë vetëhen' e tyre, dyke unjurë kryetë burravet të tyre;
- 6 Sikundrë Sarra bindeshe te Avraami, dyke quajturë atë zot; bija të së-cilësë jeni ju, kur bëni mirë edhe s'trikësohi as nga ndonjë frikë.
- 7 Ju burratë, gjithashtu, rrini bashkë *me gratë t'uaj* me urtësi, dyke dhënë nder kombit të gruasë si ene më së-dobëtë, edhe si bashkëtrashëgimtarëve të hirit të jetësë, që të mos pengonenë të-faluratë t'uaj.
- 8 Edhe më ndë funtt, *bëhi* të-gjithë mbë një mëndje, të-dhëmçurë, vëlla-dashës, të-
- 9 përdëllyersim, zëmër-ëmbëlë; Mos çpaguani të-keq për të-keq, a të-sharë për të-sharë; po përkundrazi, dyke bekuarë; sepse për këtë
- 10 uthërrittë, që të trashëgoni bekim; „Sepse kush do të dojë jetë, edhe të shohë dit të-bardha, letë pushonjë gjuhën' e ti nga e-keqia, edhe
- 11 buzët' e tia nga të-foluritë kobim. Letë mërgonetë nga e-liga, edhe letë bënë mirë: letë kërkonjë paqtim, edhe let'a ndjekë atë.
- 12 Sepse syt' e Zotit janë mbi të-drejtët, edhe veshët' e ati mbë lutjen' e atyreve; po fa-

- qeja e Zotit është kundrë atyreve që bënë një keq.“
- 13 Edhe kush dot' u bënë keq juve, ndë i
- 14 rafshi prapa së-mirësë? Po edhe ndë heqçi keq për drejtërinë, të-lumurë jeni, „edhe nga frik' e atyreve mos kini frikë, as mos trubullohi;“
- 15 Po“ shënjtëroni Zotinë, Perëndinë,“ ndë zëmërat t'uaj; edhe ini gati-përherë të epni fjalë me butësi e me frikë sicilitdo që të kërkonjë prej jush fjalë për shpresënë që
- 16 është ndër ju; Dyke pasurë ndërgjegje të-mirë, që, ndonëse flasënë keq për ju posi për keqbërës, të turpëronen' ata që përflasënë të-sjellatë t'uaj të-mira mbë Jisu Kristinë. Sepse është më mirë të hiqni keq dyke
- 17 bërë mirë, ndë është kështu dashurimi i Perëndisë, se dyke bërë keq.
- 18 Sepse edhe Krishti një herë pësoj për fajetë, i-drejti për të-shtrëmbëritë, që të na bjerë te Perëndia, dyke vdekurë pas mishit,
- 19 po dyke ungjallurë me anë të Frymësë; Me anë të së-cilësë vate e lëçiti edhe te frymatë
- 20 që ishinë ndë burkt, Të-cilatë nuk' ubintnë njëherë *moti*, kur i priste njëherë zëmër' e-gjerë e Perëndisë, ndë ditt të Nohësë, tek ndërtonej arka, ndë të-cilët të-pakë (do-methënë tetë) shpirtë shpëtuanë me anë të
- 21 ujit; Kundrëformë e të-cilit dyke qënë pagëzimi na shpëton edhe neve sot, (jo të-hedhuritë tej të ndyrësis' së mishit, po dësh-

mimi i ndërgegjes' së-mirë mbë Perëndinë,) 22 me anë të të-ngjallurit të Jisu Krishtit; I-cili vate ndë qiellt edh' është ndë të-djathtët të Perëndisë, edhe të-cilit i unjtnë kryetë ëngjëjt' e pushtetet' e fuqitë.

Krye 4.

- 1 Passi pësoj pra Krishti ndë misht për ne, armatosuni edhe ju me gjithatë mendim; sepse ay që pësoj ndë misht, pushoj nga
- 2 faji; Që t'a shkoni jetënë që u mbetetë ndë misht jo më ndë dëshërimet të njerësvet, po
- 3 ndë dashurimt të Perëndisë. Sepse mjaft është për ne koha e jetësë që shkoj, që punuamë dashurimin' e kombevet, dyke ecurë ndë ndyrësira, ndë dëshërime, ndë të-dejtura, ndë lodërti, ndë të-pira, edhe ndë idhullatri-
- 4 ra të-paudha; Edhe përandaj u vjen çudi atyreve, se nukë ecëni bashkë me ata ndë gjithatë vërshim të plankprishjesë, edhe u
- 5 shanjënë juve; Të-cilëtë dot' i apënë fjalë ati që është gati të gjykonjë të-gjallë e të-
- 6 vdekurë. Sepse për këtë ulëçit ungjilli edhe te të-vdekuritë, që të gjykonenë pas njerësvet ndë misht, e të rronjënë pas Perëndisë ndë frymët.
- 7 Edhe fundi i të-gjithave uafërua; urtësohi
- 8 pra, e rrini sgjuarë ndë të-falurat. Edhe përmbi të-gjitha ki-e-ni të-nxehëtë dashurinë ndë mest t'uaj; sepse „dashuria dotë mbu-

- 9 lonjë shumicë fajesh.“ Ki-e-ni derënë të-ha-
- 10 pëtë njëri për tjetërinë, pa murmurim. Gjithësicili sikundrë mori dhurëti, pas kësaj shërbeni-i njëri tjetërit, si kujdestarë të-mirë të
- 11 hirit shumë farësh të Perëndisë. Ndë flet ndonjë, *letë flasë fjalë* si fjalë Perëndie; ndë shërben ndonjë, *letë shërbenjë* si prej fuqisë që i ep Perëndia, që mbë të-gjitha të lavduronetë Perëndia me anë të Jisu Krishtit, mbë të-cilinë është lavdia edhe pushteti ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 12 O të-dashurë, mos u vinjë çudi juve për mundimn' e-keq qe ubë mbë ju për të provuarë juve, sikurse gjau mbë-ju ndonjë punë
- 13 e-çudiçime e-veçantë; Po gëzohi, se jeni pjesëtarë të pësimevet të Krishtit, që të gëzohi dyke ugëzuarë edhe ndë të-sbuluarët të
- 14 lavdis' s' ati. Ndë shahi për emërin' e Krishtit, jeni të-lumurë; sepse Fryma e lavdisë edhe ajo e Perëndisë prëhetë mbë ju; pas atyreve shahetë, po pas jush lavduronetë.
- 15 Sepse asndonjë prej jush letë mos pësonjë si vrasës, a si vjedhës, a si keqbërës, a si
- 16 asi që shikon punërat' e-huaj; Po ndë pësoftë si i-krishterë, letë mos ketë turp, po
- 17 letë lavduronjë Perëndinë mbë këtë; Sepse *arriti* koha të nisetë gjyqi nga shtëpia e Perëndisë; edhe nde *nisetë* më përpara nga ne, ç' dotë jetë e-pastajmja e atyreve që s'
- 18 bindenë ndë ungjillt të Perëndisë? Edhe

„ndë i-drejti mezi shpëton, i-pabesi edhe
19 fajtori ku dotë duketë ?„ Andaj edhe ata që
pësonjënë pas dashurimit të Perëndisë, letë
besonenë shpirtërat' e tyre me të punuarë
të-mirë ndë dorët t'ati si mbë besëtarinë
krietar.

Krye. 5.

- 1 U lutem pleqvet që janë ndër ju unë pla-
ku, shoku i atyreve, edhe dëshnimtar i pë-
simevet të Krishtit, edhe pjesëtar i *asaj* lav-
disë që është për të sbuluarë; Ruani gri-
gjën' e Perëndisë që është ndër ju, dyke
kujdesurë *për atë* jo me pahir, po dyke
dashurë; as për fitim të-lik, po me zëmërë
3 të-gatishime; Jo sikur se jini zotërinj mbi
trashëgimn' e *Perëndisë*, po dyke bërë vetë-
4 henë t'uaj shëmbëllesë të grigjësë. Edhe kur
të çfaqetë kryebariu, dotë merrni kurorën'
e-pafishkurë të lavdisë.
- 5 Gjithashtu *edhe ju* më të-rinjtë, unjni krye-
të pleqvet; edhe të-gjithë, dyke unjurë krye-
të njëri tjetërit, vishni mëndjen' e-përunjurë;
sepse „Perëndia u rri kundrë madhështorë-
6 vet, po të-përunjurëvet u ep hir.“ Përunjuni
pra ndënë dorët të-fortë të Perëndisë, që
t'u lartësonjë juve ndë kohët *që duhetë*;
7 Edhe gjithë kujdesnë t'uaj hidh-e-ni mb' atë,
sepse ay kujdesetë për ju.
- 8 Përmbani vetëhenë, rrii sgjuarë; sepse

- kundrë-gjyqësi juaj, djalli, posi leon që ulë-
rin, vjen përçark dyke kërkuarë cilinë të
9 përpijë. Të-cilit rrii-i kundrë *dyke qëndrua-
rë* të-fortë ndë besët, sepse e dini se gjithata
pësime bënenë ndër vëllezërit t'uaj që janë
10 ndë botët. Edhe Perëndia i çdo hiri, që na
thërriti ndë lavdit të ti të-përjetëshme me
anë të Jisu Krishtit, si të pësoni pak, ay u
bëftë të-sosurë, *u forcoftë, u dhëntë fuqi*, u
11 themelostë. Mb' atë *qoftë* lavdia edhe pu-
shteti ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 12 Me anë të Silluanit, vëllajt besëtar, u shkro-
va juve me pak fjalë, sikundrë më duketë,
dyke lutur' e dyke dhënë dëshnim, se ky
është hiri i-vërtetë i Perëndisë, *ky* ndë të-
13 cilët qëndroni. U faletë me shëndet juve
kisha që është ndë Vavilonë, *që është* e-
sgjedhurë bashkë me ju, edhe Marku, biri
14 im. Përshëndetni njëri tjetërinë me të-puthu-
rë dashurie.

Paqtim *qoftë* mbë gjithë ju që jeni mbë
Jisu Krishtinë. Amin,